

Dr. Izber Hoti

PËRDORIMI I FUSNOTAVE DHE STANDARDIZIMI I TYRE

Në vend të hyrjes

Shënimet në fund të faqeve të studimeve shkencore, apo fusnotat, janë me rëndësi të veçantë për të gjitha shkencat.

Që në fillim duhet theksuar se termi *fusnotë* nuk ka veçantitë shprehëse të mirëfillta, por ashtu e përdorin shkencëtarët në mbarë botën, prandaj nuk ka arsye që ne të veçohemi. Bëhet ky sqarim, ngase në kuadrin e shënimeve plotësuese shkencore bëjnë pjesë edhe *referencat*, që janë, pa dyshim, diçka tjetër nga fusnotat, anipse marrin karakterin e këtyre shënimeve kur përdoren në këtë formë të shprehjes shkencore.

Përdorimi i mirëfilltë i shënimeve plotësuese nga shkencëtarët shton vlerën e punimeve shkencore dhe dëshmon pjekurinë e tyre. Kjo është arsyeja që në botë kësaj çështjeje i është kushtuar kujdes i veçantë, që nuk mund të thuhet se kështu ndodh edhe tek ne. Si pasojë e kësaj mospërfilljeje dhe lëshimi në studimet shkencore shqiptare haset laryshi e madhe e përdorimit të fusnotave, madje hasen edhe gabime e dështime të plota të zbatimit të kësaj pjese të aparaturës shkencore. Thënë shkurt, njohuritë e fituara shkollore dhe universitare nuk janë të mjaftueshme, prandaj kësaj çështjeje do të duhej t'i kushtohej kujdes më i madh.

Kuptimi themelor

Aparatura shkencore e shënimeve është e nevojshme pothuajse për çdo qasje, hulumtim apo studim shkencor. Ajo ka tri funksione themelore: mbështetjen, sqarimin dhe inicimin e veprimtarisë shkencore.

Mbështetja në funksion të shënimeve si aparaturë shkencore nënkupton arsyetimin e qasjeve, të vështrimeve dhe të studimeve shkencore para

lexuesve dhe të të interesuarve të tjerë, para së gjithash për të arriturat shkencore, të cilat janë me rëndësi të veçantë dhe paraqesin kthesë në fushën e caktuar shkencore, ndërsa *sqarimi* përdoret me synim që të tjerëve t'u ofrohen të dhëna që hulumtimet dhe studimet të bëhen sa më të kapshme dhe më të afërta me lexuesin.

Krahas mbështetjes dhe sqarimit shkencëtarët me shënimet si aparaturë shkencore mund të *inicojnë* punën e mëtejshme shkencore, në të cilat për shkak të natyrës së hulumtimit dhe të studimit të ndërmarrë, por edhe për arsye të tjera, nuk do të mund t'i trajtonin si duhet dhe si lipset.

Në të trija rastet shënimet plotësojnë punën shkencore dhe pa një veprim të tillë hulumtimet dhe studimet shkencore do të mbeteshin të gjymta dhe jo të plota, për të mos thënë edhe të dështuara, me përjashtim të rasteve të veçanta, që varet nga natyra e qasjeve dhe e trajtimeve. Bile, në qarqe të caktuara dhe në momente të ndryshme studimet shkencore pa këto shënime në kuadër të aparaturës shkencore nuk konsiderohen dhe as që merren si punime shkencore.

Në botë në përgjithësi shënimet në kuadër të aparaturës shkencore njihen me nocionin fusnota. Ky term rrjedh nga gjuha gjermane dhe përbëhet nga dy fjalë (*fus* – fund + *note* – shënim), që ka kuptimin e shënimeve në fund të faqes. Këto shënime shënjohen me yje, por edhe me shenja të tjera dhe me numra të ashtuquajtur *bruh cifër* (shifër e ngritur) dhe ato rëndom janë më të vogla për dy njësi se sa teksti i hulumtimit dhe i studimit shkencor. Në disa raste, kur ka pak shënime, si shenja shqimi përdoren edhe numrat romakë.

Shenjat e shqimit në funksion të shënimeve si aparaturë shkencore nga teksti i studimit ndahen me një vizë të hollë e të gjatë, për afërshisht sa vetë fusnotat, por ndodh, pas përsosjes së teknikës së shkrimit, edhe me forma të tjera, duke përdorë katrorë dhe bokse të llojshëm shkrimi, që varet shumë nga shija e autorit, si dhe nga shija e redaktorit teknik, të studimit apo të veprës shkencore.

Shënimet si aparaturë shkencore vehen në fund të faqes, prej nga edhe kanë marrë emrin, por edhe në fund të ndonjë pjese (seksioni) të punimit shkencor, ndërsa ndonjëherë edhe në fund të veprës shkencore, që nuk është e këshillueshme. Po kështu nuk është e këshillueshme që fusnotat të vehen në fund të ndonjë pjese studimi, por është e tolerueshme.

Falë zhvillimit dhe përsosjes së kompjuterit, si dhe programeve aplikative të tij (p. sh. *Microsoft Word*), fusnotat mund të shënohen në mënyrë automatike, formë kjo që ndihmon shumë shkencëtarët. Kjo formë e shënimit të kësaj pjese të aparaturës shkencore nga ata që përdorin kompjuterin mund të mësohet me një angazhim të vogël, duke shfrytëzuar

librat për njohuritë elementare të përdorimit të kompjuterëve. Me këtë metodë mund të shfrytëzohen të gjitha format e përmendura të shkrimit të fusnotave.

Gjatë veprimtarisë shkencore ekziston edhe një formë e shënimit të fusnotave. Në të vërtetë, jo rrallë haset edhe forma e shënimit të fusnotave në tekstin shkencor, duke përdorur kllapat e vogla apo të mesme. Edhe kjo formë e shfrytëzimit të kësaj aparature shkencore aplikohet në rastet kur fusnotat nuk janë të gjata dhe nuk e ngarkojnë tekstin mbështetës shkencor. Forma e përmendur e fusnotave ka përdorim të gjerë në punimet shkencore-publicistike, veçanërisht në esetë shkencore.

Përdorimi dhe shënimi i fusnotave nuk bëhet njëjtë në gjithë botën. Madje, kjo nuk bëhet njëjtë as edhe në një vend, apo në një areal kulturor e gjuhësor. Kështu ndodh ngase edhe fusnotat, si dhe vetë hulumtimet dhe studimet shkencore, janë të ndikuara, madje për fat të keq edhe të varura, nga orientimet dhe shkollat e ndryshme të njohjes dhe të shkencës. Pra, marrë në përgjithësi çështja e mënyrës së përdorimit të shënimeve si aparaturë shkencore nuk ka marrë ende formë të prerë, anipse dihen konturat e përgjithshme dhe përdorimi i tyre dëshmon përgatitjen teoriko-metodologjike të shkencëtarëve. Kështu ndodh edhe në shkencën shqiptare.

Nevoja e përshtatjes së shënimeve

Siç është e ditur, çdo gjuhë dhe shkrim në botë ka veçantitë e veta. Për këtë arsye, krahas përpjekjeve që shënimet si aparaturë shkencore të jenë të ngjashme në mbarë botën, ato ndryshojnë nga vendi në vend. Veç kësaj, këto shënime në mbarë botën me kohë plotësohen e ndryshojnë, por kjo dukuri është më e theksuar në shkencat e reja dhe te popujt që aparaturën shkencore në përgjithësi nuk e kanë ende të standardizuar. Kështu veprohet që të jenë më afër lexuesit dhe që shkrimi t'i përgjigjet sa më shumë grafemave në përdorim.

Anipse është e njohur dhe e miratuar nga gjithë bota shkurtesa *ib* ose *ibid*, për *ibidém*, nga latinishtja e që në gjuhën shqipe do të thotë *po aty; në atë vend; në të njëtin vend; në të njëjtën vepër; në të njëjtën faqe*, kështu veprohet rrallëherë në gjuhët e ndryshme botërore, madje edhe në gjuhët me prejardhje neolatine. Kështu është vepruar edhe tek ne. Shkencëtarët janë të bindur se lexuesit dhe shfrytëzuesit e rezultateve të tyre nuk e njohin latinishten, por edhe përkthimi i kësaj shprehjeje në gjuhën shqipe nuk humb gjë dhe sinonimia shqipe mbulon plotësisht kërkesat shkencore, të cilat i bën gjuha paleolatine dhe neolatine, prandaj nuk

ngurrohet që në vend të fjalës *ibidém* të përdoren fjalët *po aty, aty*, e madje herë-herë edhe fjalë të tjera të gjuhës shqipe. Kështu është vepruar dhe veprohet edhe në gjuhët e tjera. Pra, është paraqitur dhe paraqitet nevoja që shënimet në fund të faqes në tekstet shkencore të përshtaten me gjuhën dhe semasiologjinë e gjuhës në të cilën shkruhen punimet.

Dukuria e veçimit të përdorimit të fusnotave bëhet në dëm të një aparature shkencore mbarëbotërore, por ruan veçoritë e pjesëve të botës, që pa dyshim është edhe një pasuri botërore. Veç kësaj, një veprim i tillë ndihmon lexuesit e rëndomtë të gjuhëve të ndryshme, ndërsa gjuhët ruajnë shumë veçori të tyre, prandaj këmbëngulja që të tumiret dhe të zbatohet një aparaturë e standardizuar botërore do të godaste kultura dhe shkri-me të shumta të rruzullit tokësor. Këtë në fund të fundit e dëshmoi edhe vetë historia dhe për këtë arsye shkencëtarët e vendeve të ndryshme shfrytëzojnë dhe përdorin mënyra dhe forma të ndryshme të shënimeve si aparaturë shkencore. Megjithatë, përdorimi i fusnotave nuk është standardizuar as ndër shqiptarë, siç ndodh edhe tek shumë popuj të tjerë. Mungesa e standardizimit të fusnotave pengon lexuesin e herë-herë edhe e huton atë.

Standardizimi si domosdoshmëri

Përdorimi i ndryshëm i fusnotave jo vetëm që huton dhe pengon lexuesin, por pasqyron edhe mëdyshjet e mëdha në shkencën shqiptare dhe papërsosmërinë e saj. Për këtë arsye ka herë është paraqitur nevoja që të bëhet standardizimi i aparaturës shkencore në përgjithësi, si dhe standardizimi i fusnotave. Nevoja e standardizimit të aparaturës shkencore tashmë është e domosdoshme, sepse ajo me vete bart edhe pasoja të llojshme gjuhësore e semantike, por edhe të çështjeve me karakter lëndor. Sa për ilustrim me këtë rast do të marrim vetëm një çështje me interes të ndieshëm shkencor. Mendojmë se nuk është fare njëjtë se ku do të vehet shenja inicuese e fusnotës në tekstin shkencor – para apo pas shenjave të pikësimit (pikës, presjes), apo siç ndodh, për fat të keq, kur nuk ka fare shenja të pikësimit. Nëse kjo shenjë vehet para pikës, sikur del se autori në fusnotë do të vazhdojë mendimin e vet të pakryer, ndërsa në të kundërtën, kur ajo vehet pas shenjës së pikësimit, mbështeten të dhënat apo mendimet e paraqitura me materialet që atij i duken të natyrshme dhe që i ka përdorur. Këtë dukuri nuk e hetojnë një pjesë e madhe e shkencëtarëve të cilët nuk e njohin sa duhet semasiologjinë e gjuhës shqipe në përgjithësi, ndërsa semasiologjinë e shkencave të veçanta në veçanti. Ç’është edhe më keq, shpeshherë i njëjti autor nuk ka

Angazhim për thellim të çështjes

Gjendja mbizotëruese e përdorimit dhe e shfrytëzimit të shënimeve si aparaturë shkencore ndër shkencëtarë, mendojmë, nuk është e kënaqshme, por jo edhe alarmuese. Pasqyrën e tillë e përkeqësojnë edhe më shumë ata të cilët nuk janë aftësuar si shkencëtarë, ndërsa paraqiten si të tillë. Me ta vështirë se do të ecet përpara dhe vështirë se do të bëhej dallimi midis fusnotave dhe *referencave*. Ata nuk e bëjnë këtë dallim, anipse ai mund të bëhej fare lehtë duke shfrytëzuar e përdorë edhe fjalorët më të rëndomtë të fjalëve të huaja, të cilët ndër ne, veçanërisht në shkencë, përdoren së tepërmi dhe pa kurrfarë mase, ndërsa fjalorët e përmendur nuk shfrytëzohen pothuajse fare. Ç'është e vërteta, as te një shumicë e shkencëtarëve të "dëshmuar" nuk hetohet dallimi i fusnotave dhe i referencave. Edhe pse fjala referencë përdoret njëjtë si në gjuhën angleze ashtu edhe në atë frënge, këta "shkencëtarë të dëshmuar" sikur kanë harruar se kjo fjalë ka kuptimin (e parë) e kumtimit dhe të njoftimit për dikë ose për diçka, përkatësisht se referenca është shënim apo vlerësim mbi punën e dikujt ose (në kuptimin e dytë) është rekomandim, këshillim, porosi. Për këtë arsye, me përjashtim të rekomandimeve, të këshillimeve dhe të porosive të natyrës *për këtë më gjatë shiko*: pothuajse në gjithë literaturën shkencore shqiptare mungojnë qasjet si në kuptimin e parë ashtu edhe në kuptimin e dytë të kësaj fjale, pra mungojnë të dhënat e njoftimit për dikë ose për diçka, përkatësisht mungojnë shënimet dhe vlerësimet mbi punën e dikujt, me përjashtim kur ajo bëhet me synim të njollosjes, të përfoljes dhe të përdhosjes. Këto marifetllëqe bëhen shpeshherë në tekstin shkencor dhe në këtë mënyrë ai rëndohet sa herë-herë merr përmasa të daljes jashtë temës së trajtuar dhe bëhet shumë iritues.

Me sa shihet, mund të përfundohet se mënyra dhe forma e përdorimit të shënimeve si aparaturë shkencore ndikon tërthorazi edhe drejtpërdrejt në lëndën dhe në objektin e hulumtuar dhe të studiuar. Aparatura e mirëfilltë shkencore shton vlerën e hulumtimit dhe të studimit, e bën atë më serioz dhe më të besueshëm, si dhe i jep karakter shkencor. Këtë duhet ta kenë parasysh të gjithë shkencëtarët, veçanërisht redaktorët dhe recensentët e revistave dhe të publikimeve të veçanta shkencore. Deri më tash kjo veprimtari shkencore nuk është bërë kënaqshëm, ndërsa në ditët e sotshme janë mbizotëruese rrjedhat e përkeqësimit të saj. Vetëm tubimet shkencore të karakterit teoriko-metodologjik mund të na shpëtojnë, ndërsa sa dimë ne deri më tash nuk është mbajtur ndonjë i tillë.

Dr. Izber Hoti

THE USE OF FOOTNOTES AND THEIR STANDARDIZATION

Summary

The difference between references and footnotes in their particularity is sensitive. However, in the Albanian language and other languages as well, these terms are often used as the same thing. Their right use testifies about the maturity and care of scientists and servers as some kind of proof that a certain scientific study has been done with proper dedication. However, this is not what happens with all the scientific works and studies, not only because of a lack of scientific preparedness of researches and scholars, but also for the lack of standardization of scientific apparatus. This happens in particular with sciences that are recent and have not yet attained their forms, and with nations and peoples who are just starting to think and write scientifically. The Albanian science belongs somewhere in between; therefore it too needs a certain standardization of scientific apparatus to which footnotes also belong. This paper is but a start in such an enterprise. The need for having a wider, organized and institutional activity in this spirit is necessary, even more so when in the field of Albanian science, especially in the works of publicist character, an intolerable and amateur diversity.

reputatului Clubului de fotbal

„IT'U ÎNTR-UN TRAI SĂRĂCĂSĂȘI ÎN LUNA DE IANUARIE
CĂRE NE DĂDĂ UN PRONUNȚAT ȘI SĂRĂCĂȘI
CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

„CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

„CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

„CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

„CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

„CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

„CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

„CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

„CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

AKTIVITETE

„CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

„CĂRĂȘI DE LA NOI PĂRȚI”

